**3.** Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

**4.** Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare;
  - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

## DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Cdo Operatori Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Njoftimin e Kontratës, Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti/enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti /enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
    - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
    - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të

rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Grafiku i realizimit të punimeve

Shtojca 7: Formularët e Përshtatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve

Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit

Shtojca 10: Preventivat e Punimeve

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.

Shtojca 12 - Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 13 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit) .

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër  
(Pas procesit të ankimit)

**Shtojca1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontrates;
  3. Kriteret e Vlerësimit;
  4. Kriteret e Përzgjedhjes;
  5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
  6. Preventivin e çmimeve
  7. Termat e referencës (nëse është rasti)
  8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
  9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	

**Shtojca2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVESIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventividhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëratë paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomikee detajuar**

<b>Nr</b>	<b>Nr. Analizë</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi/ Njësi</b>	<b>Cmimi total</b>
1.						
2.						
3.						
<b>Shuma</b>						
<b>Fondi Rezervë</b>						
<b>Shuma</b>						
<b>TVSH</b>						
<b>SHUMA TOTAL</b>						

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )**Shtojca 3.**



[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]  
 [ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / *Nr. Referencës në faqen e APP-se*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit /entit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet** të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve: Bashkengjitur

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**GRAFIKUT IZBATIMIT TËPUNIMEVE**

**Afatet e realizimit të punimeve:120 dite**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>				
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Java 1/Muaji 1</b>	<b>Java 2/Muaji 2</b>	<b>Java 3/Muaji 3</b>	<b>Java 4/Muaji 4</b>	<b>Java 5/Muaji 5</b>
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (*tre*) viteve të fundit (**2019, 2020, 2021**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

**2.2.2.** Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (*tre*) viteve të fundit (**2019, 2020, 2021**), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

**2.2.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 26

“Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:**

a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që ështërealizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit tëkontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:**

**-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:** Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9)

i shoqëruar me:

-Kontratë punimesh;

-Situacion përfundimtar;

-Akt-kolaudimi;

-Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:**

Formulari i vlerësimit i shoqëruar me:

-Kontratë punimesh,

-Situacionin përfundimtar,

-Akt-kolaudimin,

-Çertifikatën e marrjes ne dorezim,

- Faturat tatimore per cdo situacion punimesh.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Investitorit.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit

dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

### **Punime të Përgjithshme Ndërtimi**

- NP.1 A, Punime gjurmimi në tokë.
- NP- 2 A Ndërtime civile dhe industriale
- NP.4 A, Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- NP.6 A, Punime nentokesore ,ura e vepra arti.
  
- N.S-6 A, Sinjalistike rrugore jo ndricuese
- N.S 18 A, Punime topogjeodezike

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

#### **a) Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatoret Ekonomike:**

Operatori Ekonomik duhet të paraqese certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, sipas standardeve:

- Certificate ISO 9001 - 2015 “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Certificate ISO 14001-2015 “Per sistemin e menaxhimit te mjedisit”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Certificate ISO 45001-2018“Per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mesipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

#### **2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:**

- a) Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të **paktën 30 punonjës** për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit (**Shtator 2022-Nendor 2022**) duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.



**Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:**

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

**b) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, Drejtuesit Teknik si me poshte:**

- Inxhinier Topograf/Makshajder1(nje)
- Inxhinier Ndertimi 1(nje)

Drejtuesit Teknik të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë, të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, të këna kontrate pune të vlefshme, të deklarojnë se nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Operatori Ekonomik përmbushjen e këtij kriteri duhet ta përcaktojë me anë të një deklaratë nga administratori i shoqërisë për personelin kryesor, Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të vepohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

**Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas Shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, për Drejtuesit Teknik duhet të dorëzojë dokumentacionin:**

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate;
- Diplomë profesionale;
- CV
- Libreze pune
- Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve sipas parashikimeve të Ligjit Nr.8734 datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

**2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij personel të kualifikuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për për të paktën muajin e fundit, me profesione si me poshte:**

- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar **1(nje) punonjës** të paisur me certifikate trajnimi për **”Pergjegjes për Sigurim dhe Mbrojtjen në Punë”**(certifikate trajnimi).
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **1(nje)Teknik ndertimi** për këto duhet të paraqes Kontrate individuale pune të vlefshme ,Diplome ose deshmi Aftesie

Profesionale(te vlefshme),deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese ,si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **2(dy)Monovratore** per kete duhet te paraqes Kontrate individuale pune te vlefshme , deshmi Aftesie Profesionale(te vlefshme),deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese ,si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **2(dy)Shofer** per kete duhet te paraqes Kontrate individuale pune te vlefshme , deshmi Aftesie Profesionale(te vlefshme),deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese ,si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1(nje)Karpentier** per kete duhet te paraqes Kontrate individuale pune te vlefshme , deshmi Aftesie Profesionale(te vlefshme),deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese ,si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1(nje)Murator** per kete duhet te paraqes Kontrate individuale pune te vlefshme , deshmi Aftesie Profesionale(te vlefshme),deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese ,si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.

**Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas Shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:**

- Deshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit te Transportit Rrugor;
- Kontrate pune / sherbimi te vlefshme;
- Karte personale e sigurimit teknik të vlefshme te lëshuara te lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

**2.3.5 Operatori Ekonomik duhet te paraqese licence III.2.B per “Grumbullimi dhe transportim i mbetjeve inerte jo te rrezikshme”.**

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet te kete **1 (një) ekspert per Mbrojtje nga zjarri me kontrate pune dhe QKL.**

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet *te kete te punesuar mjekun e shoqerise* ose mjek te kontraktuar nga jashte me kontrate sherbimi / me subjekte te specializuara per kete qellim. Mjeket te jene te pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. **Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit qe ploteson kriteret e VKM Nr.742 date 06.11.2013, duhet te plotesoje kete kerkese.**

### 2.3.8. Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronesia	Sasia minimumi
1	<b>Kamion mbajtes deri 25 ton</b>	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
2	Kamion vetshkarues deri 8 ton	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
3	Kamion vetshkarues deri 5 ton	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
4	Kamioncine me kapacitet mbajtes 1.5 deri 3.5 ton	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
5	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qera	2 (dy) cope
6	Autopompe betoni	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
7	Betoniere te vogla 0.5 m <sup>3</sup>	Ne pronesi ose me qera	2 (dy) cope
8	Grejder	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
9	Asfaltshtruese	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
10	Bitumatrice	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
11	Depozite uji 5000 lit	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
12	Gjenerator 100 kv	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
13	Eskavator me goma	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
14	Rula ngjeshes	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
15	Minieskavator	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
16	Eskavator me zinxhire	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
17	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
18	Kontinier i levizshem	Ne pronesi ose me qera	1 (nje) cope
19	Nyje per inerte betoni; (ne pronesi/me qera/kontrate furnizimi)	Ne pronesi ose me qera ose Kontrate Furnizimi	1 (nje) cope
20	Fabrike Asfaltbetoni me QKL	Ne pronesi ose me qera ose Kontrate Furnizimi	1 (nje) cope

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Per miratimin e Rregullores per sigurine ne kantier", si më poshtë vijon:

- Kokore + Jeleke fosforoshente minimumi 20 cope.
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 2 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 1 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 2 copë

➤ Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 4 copë

Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton pronesine e mjetit (certifikate pronesia), dokument qe verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (police sigurimi); te vlefshme. Per mjetet e siguruar me qera, te paraqiten dokumentet qe vertetojne rregjistrimin e tij, plus certifikaten e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit te vlefshme. Keto dokumente duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerese te vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet e tjera qe nuk jane te shenuara ne rregjistra publike duhet te paraqitet kontrate noteriale e blerjes / fature tatimore / dokument zhdoganimi te mjetit.

Per pajisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesia origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-bletje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje,deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Per pajisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt shoqeruar me akt pronesia origjinal ose fotokopje te noterizuar(kontrata shit-bletje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë **foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje**. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkua në procedurën e prokurimit publik** si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

### **2.3.9 Afati i kryerjes së punimeve:**

Afati i kryerjes se punimeve eshte 65 dite **sipas** grafikut te punimeve te publikuar ne SPE.

Operatori Ekonomik duhet te paraqese grafikun e punimeve ne perputhje me afatin kohor qe eshte lene ne dispozicion per realizimin e kontrates.

**Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.**

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 date 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

**Shtojca9**

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

**FORMULAR VLERËSIMI****(Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)**

Autoriteti ose Enti kontraktor/Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
<b>VËRTETOJ SE:</b>	
Autoriteti ose enti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me	
Emri i operatorit NIPT/  Bashkimit të operatorëve NIPTET/  Nënkontraktoret NIPTET	
Adresa/t	
Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar	
Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur
	E papërmbushur
<b>Firma</b>	
<b>Vula e Autoritetit/Entit Kontraktor</b>	

**Shtojca 10**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti /enti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

(Bashkengjitur)

**Shtojca11:****Formulari i Njoftimit të Skualifikimit2**

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

---

---

---

---

